



FONDI I SIGURIMIT PENSIONAL DHE INVALIDOR I MAQEDONISË



Adresa: Rruga „23 Oktomvri“ nr. 11, 1000 Shkup; E-mail: info@piom.com.mk
Qendra Tel: (02) 3250-100; Fax: (02) 3162-275; Komisionet Invalidore Tel: (02) 3065-184

Në përputhje me Ligjin për shitjen dhe dhënien me qira të ndërtesave afariste dhe hapësirave afariste të Republikës së Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 13/13, 69/13, 27/14, 42/14, 178/14, 180/14, 51/15, 61/15, 129/15, 6/16 dhe 106/16), dhe Rrregulloren mbi mënyrën dhe kushtet për shitjen dhe dhënien me qira të hapësirës afariste në pronësi apo shfrytëzim të përhershëm të Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.197/14 dhe 176/15).

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë
PUBLIKON

SH P A L L J E nr. 04/2018

PËR DHËNIEN E HAPËSIRËS AFARISTE ME QIRA PËRMES ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

LËNDË E ANKANDIT ELEKTRONIK PUBLIK

Lëndë e ankandit elektronik publik është **DHËNIA E HAPËSIRËS AFARISTE ME QIRA**, në pronësi apo i dhënë në përdorim të përhershëm Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë në përputhje me Pasqyrën tabelore e cila përmban të dhënat për hapësirën afariste, numrin e parcelës kadastrale, sipërfaqen e hapësirës afariste, adresën, çmimin total fillestar, garancinë bankare, afatin dhe kohën e dorëzimit të ankandit publik.

Hapësira afariste nga pasqyra tabelore jepet për një periudhë prej 2 vjetësh me mundësi për vazhdimin e marrëveshjes, gjegjësisht lidhjen e një kontrate të re për dy vjet duke bërë një vlerësim të ri të vlerës së hapësirës afariste dhe i njejtë solemnizohet në Noter në shpenzimet e ofruesit më të volitshëm.

Hapësira afariste e nënvizuar në pasqyrën tabelore nuk mundet që të përdoret për veprimtari e cila paraqet pengesë gjegjësisht do të konsiderohet i banimit ose banimin e qiramarrësve (pensionistëve) në shtëpitë e pensionistëve. Aktivitetet e tilla mundet të jenë: restorant, palestër, aktivitet i cili është i shoqëruar me zhurmë dhe ngajshëm. Nga këta arsye ofruesi duhet që të specifikojë veprimtarinë të cilën do ta kishte ushtruar në hapësirën afariste.

Nr.R. i auksionit	Numri i parcelës kadastrale, Komuna kadastrale dhe Fletëpronësia	Qyteti, Komuna, adresa	Përshkrim i hapësirës afariste	Sipërfaqja M2	Çmimi total fillestar në denarë (vlera e parashikuar e tregut) pa TVSH	Vëra totale e vlerësuar në hapësirën afariste në denarë	Garanci bankare për seriozitetin e ofruesit në denarë, 2% nga vlera totale e vlerësuar	Koha e fillimit të ankandit publik
1	2	3	4	5	6	7	8	10
1.)	PK 778, KK Kisella Vodë -2, FP 2829	Shkup –Aerodrom, rr. Angell Dimovski nr.4	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrum përdhesë	19	4.281	856.110	17.122	12.10.2018 10:00 ora
2.)	PK 778, KK Kisella Vodë -2, FP 2829	Shkup –Aerodrom, rr. Angell Dimovski nr.4	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrum përdhesë	16	3.481	696.119	13.922	12.10.2018 10:05 ora
3.)	PK 778, KK Kisella Vodë -2, FP 2829	Shkup –Aerodrom, rr. Angell Dimovski nr.4	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrum përdhesë	54	11.703	2.340.506	46.810	12.10.2018 10:10 ora
4.)	PK 778, KK Kisella Vodë -2, FP 2829	Shkup –Aerodrom, rr. Angell Dimovski nr.4	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrum bodrum	190	32.962	6.592.370	131.847	12.10.2018 10:15 ora
5.)	PK 1042/2, KK Gazi Babë, FP 9232	Shkup – Gazi Babë, rr. Jani Llukrovski nr. 3	Shtëpia e pensionistëve – Aerodrum bodrum	243	40.296	8.059.268	161.185	12.10.2018 10:20 ora
6.)	PK 6418/1, KK Gjorçe Petrov 6, FP 96051	Shkup – Gjorçe Petrov, rr. Gjorçe Petrov nr. 12 a	Shtëpia e pensionistëve – Gjorçe Petrov Hapësira në katin 1	25	4.987	997.407	19.948	12.10.2018 10:25 ora
7.)	PK 1732, KK Butel, FP 12193	Shkup – Shuto Orizare, rr. Shuto Orizare p.n.	Klubi i pensionistëve- Shuto Orizarer bodrum	164	16.221	3.244.187	64.884	12.10.2018 10:30 ora
8.)	PK 13554, KK Prilep, FP 57713	Prilep, Prilep, rr. Dimo Narednikot p.n.	Shtëpia e pensionistëve – Prilep përdhesë	87	11.787	2.357.480	47.150	12.10.2018 10:35 ora
9.)	PK 5130, KK Gostivar-2, FP 34272	Gostivar, Gostivar, rr. Major Çede Filipovski nr 17 b	Shtëpia e pensionistëve – Gostivar (sht.vje.pens.) përdhesë	41	11.047	2.209.326	44.187	12.10.2018 10:40 ora

E DREJTA E PJESËMARRJES

Të drejtë pjesëmarrje në ankand publik kanë:

1. **Personat fizik:** shtetas të Republikës së Maqedonisë, shtetas të vendeve anëtare në Unionin Evropian dhe në OECD, si dhe shtetas të vendeve të cilat nuk janë anëtarë në Unionin Evropian dhe OECD ndërsa në kushte reciproke mund që të fitojnë të drejtën e pronësisë së hapësirave afariste në teritorin e Republikës së Maqedonisë.

2. **Personat juridik:** person juridik vendas, person juridik në pronësi të përbashkët, person juridik i themeluar nga person i huaj fizik dhe juridik, të regjistruar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, persona të huaj juridik rezident të vendeve anëtare në Unionin Evropian dhe në OECD, si dhe persona të huaj juridik rezident të vendeve të cilat nuk janë anëtarë të Unionit Evropian dhe në OECD, që në kushte reciproke mund të fitojnë të drejtën në pronësi të hapësirave afriste në teritorin e Republikës së Maqedonisë.

KUSHTET PËR PJESËMARRJE NË ANKAND ELEKTRONIK PUBLIK

Personat e interesuar fizik dhe juridik dorëzojnë fletëparaqitje për pjesëmarrje në ankand publik, në mënyrë elektronike për secilën hapësirë afariste veçmas, në të cilën është e nënvizuar se për cilën parcelë gjegjësisht hapësirë afariste nga pasqyra tabelore i dedikohet fletëparaqitjes, e kompletuar me provat në vijim:

1. Fletëparaqitje nga parashtruesi në të cilën janë nënvizuar të dhënat mbi parashtruesin e fletëparaqitjes (emri dhe mbiemri, gjegjësisht: titulli, adresa, telefoni për kontakt),
2. Garanci bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankand publik në shumë prej..... (2% e vlerës së përlllogaritur) me afat të vlefshmërisë prej 60 ditësh nga dita e ankandit publik vetëm në origjinal (të shënohet numri rendor i pasqyrës tabelore dhe adresa ku gjendet objekti afarist),
3. Për personat fizik- vërtetësi mbi shtetësinë, origjinal ose kopje e noterizuar, jo më të vjetër se 6 muaj
4. Për personat juridik – dëshmi për regjistrimin e personit juridik në regjistrin përkatës, origjinal ose kopje e noterizuar, jo më të vjetër se 6 muaj,
5. Vërtetim se nuk është hapur procedurë falimentimi apo likuidimi,
6. Certifikatë se me aktgjykim nuk i është shqyptuar masa e sigurisë: ndalesë për kryerjen e veprimtarisë,
7. Deklaratë e verifikuar në NOTER se në cilën do bazë nuk ka detyrime të papaguara ndaj Fondit për sigurim pensional dhe invalidor të Maqedonisë.
8. Pjesëmarrësit e interesuar regjistrohen në portalin www.deloven-prostor.mk me regjistrimin e e-mail adresës së parashtruesit të fletëparaqitjes, nëpërmjet së cilës do të realizohet procedurat e regjistrimit për pjesëmarrje në ankandin publik elektronik, duhet që të aktivizon llo garinë (Shih udhëzim për përfituesit në www.deloven-prostor.mk)

Dokumentet nën numër rendor 1, 3, 4, 5, 6 dhe 7 duhet të jenë të skanuara në PDF dokumentet dhe i bashkangjitet fletëparaqitjes edhe atë në pjesën “Deklaratë”

Garancia bankare (dokumentin nën numër rendor 2) skanohet në PDF format dhe i bashkangjitet paraqitjes edhe atë në pjesën “Garanci bankare”.

Përveç bashkangjities së këtyre dokumenteve në mënyrë elektronike, detyrimisht këto dokumente, garancia bankare – origjinal dhe dokumentet nën numër rendor 1, 3, 4, 5, 6 dhe 7 (në origjinal apo kopje e verifikuar në noter) të dorëzohen edhe te Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë në rr. 23 oktombri nr.11 në Shkup, më së voni deri në ditën e fundit për parashtrimin e fletëparaqitjes.

Fletëparaqitjet që nuk janë kompletuar me këto prova nuk do të marrin pjesë në ankand elektronik publik, me çka parashtruesit e fletëparaqitjeve jo të kompletuara do të njoftohen në mënyrë elektronike.

AFATET

Fletëparaqitjet për pjesëmarrje në ankand publik mund të parashtrihen përfundimisht më 08.10.2018 deri në ora 15,00 në mënyrë elektronike në faqen e internetit: www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të mbahet në mënyrë elektronike në këtë faqe të internetit: www.deloven-prostor.mk

Ankandi publik do të fillojë në terminin e shënuar në pasqyrën tabelore, për secilën hapësirë afariste veçmas..

PROCEDURA

1. Pas pranimit të fletëparaqitjes, Komisioni përcakton plotësinë e dokumentacionit në përputhje me kushtet në shpallje, pas së cilës informon parashtruesit e fletëparaqitjes në mënyrë elektronike.
2. Parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilat janë të kompletuara, Komisioni në mënyrë elektronike ua miraton pjesëmarrjen në ankand publik me çka edhe njoftohen në mënyrë elektronike përmes e-mail-it, ndërsa parashtruesve të fletëparaqitjeve të cilët nuk kanë dorëzuar dokumentacion të kompletuar, komisioni nuk ua miraton pjesëmarrjen në ankand publik, me çka edhe i njofton në mënyrë elektronike për arsyet e rrefuzimit.
3. Parashtruesit e fletëparaqitjeve të cilët kanë dorëzuar flatëparaqitje të plota për pjesëmarrje në ankand publik në mbështetje me shpalljen, në ditën e zbatimit të ankandit publik regjistrohen në faqen e internetit të nënvizuar në shpallje me emrin shfrytëzues dhe shifër për pjesëmarrje në ankandin publik, me çka fitojnë të drejtën e pjesëmarrjes në ankand publik,.
4. Ankandi publik do të mbahet nëse pjesëmarrësit i plotësojnë kushtet e përcaktuara në shpallje.
5. Ankandi publik do të mbahet edhe nëse pas shpalljes është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i cili plotëson kushtet e përcaktuara në shpallje.
6. Ankandi publik fillon me shpalljen e çmimit total fillestar të hapësirës afariste dhe zbatohet me ankand nga ana e pjesëmarrësve. Në pesë minutat e para të ankandit publik pjesëmarrësit mund ta pranojnë, përkatësisht të rrisin çmimin e hapësirës afariste. Ankandi publik konsiderohet i përfunduar në momentin e kalimit të kohës së përcaktuar në shpalljes, me çka nëse në dy minutat e fundit të kohës së caktuar për kohëzgjatjen e ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është dhënë oferta, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik do të zgjatet edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në periudhën e dy minutave të ardhshme nuk do të jepet ofertë e re.
7. Ankandi publik vazhdon një kohë të pacaktuar deri kur në një interval prej dy minutash ka ofertë të re. Nëse në pesë minutat e para të ankandit publik nuk është pranuar oferta, përkatësisht nuk është dhënë një më e lartë, çmimi total fillestar i hapësirës afariste reduktohet për 2% sipas së cilit pjesëmarrësit e ankandit publik sërish do të kenë mundësinë të pranojnë, përkatësisht rrisin çmimin e hapësirës afariste.
8. Nëse në dy minutat e fundit nga pesë minutat e dyta të ankandit publik nga ana e pjesëmarrësve është pranuar oferta, përkatësisht është dhënë ofertë më e lartë, afati përfundimtar për përfundimin e ankandit publik vazhdon edhe për dy minuta, ndërsa do të përfundojë kur në dy minutat e ardhshme nuk është dhënë ofertë e re.
9. Nëse në kohëzgjatjen e pesë minutave përsëri nuk ka asnjë ofertë, vlera e hapësirës afariste sërish reduktohet për 2% nga çmimi total fillestar i hapësirës afariste. Reduktimi i çmimit total fillestar i hapësirës afariste gjatë ankandit mund të arrijë më së shumti në 30% nga vlera e caktuar e tregut të hapësirës afariste, pa marrë parasysh se sa ofruer janë paraqitur në ankand publik.

10. Komisioni pas përfundimit të ankandit publik përgatit procesverbal për ankandin publik të zbatuar i cili u dorëzohet të gjithë pjesëmarrësve në ankand publik.
11. Po qe se bëhet fjalë për shpalljen e publikuar për herë të dytë, vlera e përlllogaritur e hapësirës afariste mund të reduktohet deri në 30% po qe se në ankandin publik është paraqitur vetëm një pjesëmarrës i interesuar, gjegjësisht deri në 50% po qe se janë paraqitur dy ose më shumë pjesëmarrës,
12. Pjesëmarrësit në ankand publik kanë të drejtë të kundërshtojnë vetëm në lidhje me procedurën e ankandit publik, në afat prej tre ditësh nga mbajtja e ankandit publik, deri te Komisioni i cili vendos me Aktvendim sipas kundërshtimit, brenda 5 ditëve nga pranimi i kundërshtimit.
13. Si ofrues më i mirë konsiderohet pjesëmarrësi i ankandit publik i cili ka ofruar çmimin total përfundimtar më të lartë i cili përfaqëson çmim më të lartë për shitjen e hapësirës afariste.
14. Ofruesi më i volitshëm është i detyruar që brenda 15 ditëve nga pranimi i njoftimit me shkrim mbi zgjedhjen të paguajë mjetet në përputhje me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit dhe Komisionit t'ia dorëzojë dëshminë mbi pagesën e kryer. Nëse ofruesi më i volitshëm nuk i paguan mjetet në përputhje me çmimin e arritur përfundimtar të ankandit në po këtë afat, nuk do të nënshkruajë marrëveshjen, ndërsa garancia bankare për seriozitetin e ofertës do të aktivizohet dhe ofruesit do t'i shqiptohet ndalesë për pjesëmarrje në procedurën për ankand publik për tjetërsimin apo dhënien me qira të hapësirave afariste, për një periudhë prej një viti nga dita e shqiptimit të ndalesës.
15. Garancia bankare për seriozitetin e ofertës për pjesëmarrje në ankand publik do t'i kthehet parashtruesit të fletëparaqitjes në afat prej 15 ditësh nga dita e mbajtjes së ankandit publik, ndërsa garancia bankare ofruesit më të volitshëm do t'i kthehet që nga momenti i nënshkrimit të kontratës për shitblerje.
16. Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë në afat prej 5 ditë pas pagesës së bërë të çmimit lidh kontratë për shitblerjen e hapësirës afariste me ofruesin më të volitshëm.
17. Kontrata për shitblerjen e hapësirës afariste lidhet në periudhë prej 2 viteve me mundësi të vazhdimit përkatësisht lidhjes së kontratës së re për edhe dy vite me përpunimin e vlerësimit të ri të vlerës së hapësirës afariste dhe i njëjti solemnizohet në Noter në shpenzim të ofertuesit më të volitshëm.

Kjo shpallje do të publikohet edhe në WEB faqen e Fondit të sigurimit pensional dhe invalidor të Maqedonisë, www.plom.com.mk dhe në faqen e internetit : www.deloven-prostor.mk

Të interesuarit, hapësirën afariste mund ta shohin çdo ditë pune prej orës 10,00 deri në orën 14,00.

Informata më të hollësishme mund të merren në selinë e Fondit të SPIM-së – Shkup, rr. 23 Oktomvri nr.11.

Personat për kontakt:

Ajredin Amzai tel.. 070/360-243

Luben Veljanoski tel. 071/392-576

Fondi i sigurimit pensional dhe invalidor i Maqedonisë
Komisioni për zbatimin e procedurës për ankand publik

Kryetar

Ajredin Amzai